



DEMOCRACYPLUS

MONITORIMI I ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NËNTOR, 2020



MONITORIMI I ZBATIMIT

TË LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR
SHËRBIMIN E JASHTËM TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NËNTOR, 2020

Falënderojmë **National Endowment for Democracy (NED)** për përkrahjen financiare në këtë iniciativë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Ky raport është përgatitur nga **Emir Abrashi**.

Design and Layout: **Envinion**

Për më shumë informata vizitoni **www.dplus.org**

Përmbajtja

I. HYRJE	6
II. METODOLOGJIA	10
III. LEGJISLACIONI QE RREGULLON FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË JASHTËM	12
IV. INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË JASHTËM	13
V. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI	14
MANGËSITË NË LEGJISLACIONIN AKTUAL	14
A. EMËRIMET POLITIKE	14
B. MUNGESA E KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL DHE BRENDA-INSTITUCIONAL.....	14
C. ROLI I KOMISIONIT PËR PUNË TË JASHTME.....	14
D. ROLI I AKADEMISË DIPLOMATIKE	15
E. PAGAT BAZË DHE SHITESAT	16
F. SHKOLLIMI I FËMIJËVE.....	17
VI. PROJEKTLIGJI NR. 06/L-154 PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	18
A. SHTETËSIA E SHEFIT TË MISIONIT	19
B. TRAJTIMI I FAMILJEVE TË DIPLOMATËVE	19
C. TËRHEQJA E PARAKOHSHME E SHEFIT TË MISIONIT	20
D. DHËNIA E GRADAVE	20
E. KONSUJT E NDERIT	20
F. PËRFAQËSIMI GJINOR	21
VII. REKOMANDIMET	22
SHTOJCA I: PROPOZIMI E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME NË GJENEVË LIDHUR ME FUTJEN E NENIT TË VEÇANTË I CILI TRAJTON ÇËSHTJEN E FAMILJARËVE TË DIPLOMATËVE	24

I. Hyrje

Politika e jashtme e një shteti orientohet nga strategjitë e interesave të cilat shteti i vendosë dhe për të cilat angazhohet për t'i mbrojtur si interesa kombëtare, si dhe angazhohet për t'i arritur brenda kuadrit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Qasja ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare bëhet në mënyrë strategjike për t'i kultivuar marrëdhëniet me shtetet tjera. Në dekadat e fundit, për shkak të globalizmit dhe aktiviteteve ndërkombëtare, shtetet duhet të bashkëveprojnë edhe me institucione jo-publike. Këto ndërveprime kanë për qëllim arritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar bilateral dhe multilateral.

Marrëdhëniet diplomatike mes shteteve rregullohen përmes Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961), si dhe Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1963). Republika e Kosovës e ka themeluar Ministrinë e saj të Punëve të Jashtme në muajin mars 2008, duke u mbështetur në Kapitullin IV, Neni 65 pika 1 dhe Neni 96 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit, thellimit dhe ushtrimit të marrëdhënieve me shtetet dhe organizatat e tjera, subjekti i së drejtës ndërkombëtare.

Ligji nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 mars 2008, duke shënuar kështu edhe themelimin e shërbimit diplomatik të Republikës së Kosovës. Ky Ligj është ndryshuar dhe plotësuar me **Ligjin Nr. 03/L-207**, i dekretuar nga Presidenti Republikës së Kosovës më 8 korrik 2010. Ky Ligj është aktualisht në fuqi, dhe rregullon Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, ani pse ka pasur disa tentativa nga qeveritë e kaluara të Republikës së Kosovës për të bërë një Ligj të ri, i cili do të bënte rregullimin më të detajuar të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës.



BAZUAR NË LIGJIN PËR MPJ¹-NË, NENI 3 “MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMI DIPLOMATIK I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË CILAT E PËRBËJNË MINISTRINË DHE PERSONELIN E SAJ NË AMBASADA JASHTË, JANË PJESË E QEVERISË SË KOSOVËS”. PO ASHTU, PIKA 3.2 E PO TË NJËJTIT NEN PËRCAKTON SE “MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME FORMULON DHE ZBATON POLITIKËN E JASHTME TË KOSOVËS”.

1 Ministrisë së Punëve të Jashtme, që nga viti 2020, i është shtuar edhe komponenta e Diasporës, dhe shkurtesa zyrtare për këtë dikaster është MPJD. Në këtë raport shkurtesa e përdorur për t'ju referuar kësaj Ministrie është MPJ duke pasur parasysh se legjislati aktualisht në fuqi i referohet këtij dikasteri pa komponentën e Diasporës.

Në këtë kuadër, Ministri/ja i/e Punëve të Jashtme bën menaxhimin e Ministrisë, Ambasadave, gjithnjë në koordinim me Kryeministrin dhe Qeverinë, por duke u konsultuar edhe me Presidentin e Republikës, si dhe duke i raportuar Kuvendit të Republikës. Neni 84 (10) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që: “[Presidenti i Republikës së Kosovës]: ... udhëheq politikën e jashtme të vendit;”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që Ministri i Punëve të Jashtme i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, pasi që Neni 65 (10) i Kushtetutës: [Kuvendi i Republikës së Kosovës]: ... (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;”.

Neni 93 (1) i Kushtetutës parasheh që [Qeveria]: propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;, ndërsa Neni 94 (4) obligon që: [Kryeministri]: ... këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit”.

Nga kjo mund të kuptohet që politika e jashtme e vendit kërkon një koordinim kompleks mes institucioneve më të larta në hierarkinë e shtetit, dhe e njëjta duhet të bëhet duke mos paragjykuar pozicionin politik të njëjës palë apo tjetrës. Ministri/ja i/e Punëve të Jashtme duhet të bëjë balancimin dhe koordinimin mes të gjitha këtyre institucioneve, para se të përpilojë qëndrime shtetërore për çështje të caktuara, me anë të të cilave edhe do të përfaqësohet shteti në kuadrin e jashtëm.

Në anën tjetër, misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës duhet që gjithnjë ta ruajnë paanësinë e tyre politike, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë që të bëhen subjekt i përpilimit të qëndrimeve të cilat nuk janë në linjë me qëndrimin zyrtar të krerëve institucional. Për këtë arsye, me rastin e punësimit në shërbimin e jashtëm, diplomatët e Republikës së Kosovës parashihet që do të pushojnë çfarëdo aktiviteti politik në të cilin kanë qenë të angazhuar më herët, duke u bazuar në pikën 1.2 të Nenit 32 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, i cili obligon që “[nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë] të pezullojë aktivitetin e tij në një parti, organizatë ose shoqatë politike gjatë periudhës në shërbimin e jashtëm”. Diplomtatët nuk duhet që assesi të mbajnë anë në raste të mos-koordinimit ndër-institucional në vend, dhe për çfarëdo qëndrimi zyrtar në shtetin pritës duhet ta bashkërendojnë me MPJ-në, si dhe në çfarëdo rrethane duhet të mbrojnë interesat dhe integritetin e vendit në vendin ku janë të akredituar.

Ministria e Puëve të Jashtme është autoriteti bashkërendues për të gjitha bashkëpunimet ndërkombëtare të të gjitha institucioneve. Neni 4 i Ligjit nr. L/03-044 parasheh që:

“4.1 Ministri i Punëve të Jashtme, Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, kanë autoritet për të nënshkruar traktate dhe konventa obligative ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës dhe për të nënshkruar instrumente të aderimit në konventat ndërkombëtare të cilat veç janë në fuqi.

4.2 Ministri mund t’ua delegojë me shkrim këtë autoritet, përkitazi me traktatet dhe konventat e caktuara:

A krerëve të ambasadave të Republikës së Kosovës ose misioneve diplomatike jashtë vendit;

B ministrave tjerë brenda përgjegjësive të të cilave bie fushë veprimtaria e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Megjithatë, i njëjti Ligj parasheh që edhe pas nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, nëse të njëjtat janë traktate dhe konventa obligative ndërkombëtare, ato nuk hyjnë në fuqi në Kosovë derisa të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pika 4.3, e Nenit 4 të po të njëjtit Ligj obligon që: *“...Këto ratifikime shpallen nga Presidenti dhe publikohen së bashku me tekstin e traktateve ose marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse në Gazetën Zyrtare”*.

Misionet e Republikës së Kosovës ndahen në Misione Diplomatike, ku bëjnë pjesë ambasadat dhe misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare, dhe Misione Konsullore, ku bëjnë pjesë konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore.

Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-122 parasheh që:

- 1.** Misionet diplomatike të Republikës së Kosovës hapen, riorganizohen dhe mbyllen me vendim të Presidentit të Republikës, pas konsultimit me Kryeministrin;
- 2.** Misionet diplomatike veprojnë nën mbikëqyrjen dhe në pajtim me udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- 3.** Mënyra e funksionimit, struktura dhe numri i personelit të misioneve diplomatike përcaktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme”.

Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës hapen në vendet tjera pas nënshkrimit të marrëdhënieve diplomatike me vendet tjera, si dhe pas marrjes së pëlqimit nga ato vende për hapjen e këtyre misioneve në vendet pritëse. Rregullimi i hapjes së këtyre misioneve, përfshirë këtu privilegjet dhe imunitetet, bëhet duke u bazuar në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961) si dhe në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1963). Personeli i Ambasadave është i përbërë nga Ambasadori/Shefi i Misionit, personeli diplomatik, stafi teknik dhe administrativ si dhe personeli shërbyes. Një ambasadë mund të jetë akredituar në më shumë se një vend, dhe në atë rast Ambasadori/Shefi i Misionit shërben si përfaqësues jo-rezident i Republikës së Kosovës në vendet e treta. Stafi diplomatik i cili shërben në Ambasada, janë diplomatë karriere të cilët janë pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës. Pjesë e këtij stafi, mund të jenë edhe personel i deleguar nga ministritë e tjera, për shërbime të caktuara në ambasada, si në rastin e Atasheve ushtarak, të deleguar nga Ministria e Mbrojtjes, Atasheve policor, të deleguar nga Ministria e Punëve të Brendshme, etj. Zakonisht, stafi i cili nuk është pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, paguhet nga ministritë të cilat i kanë deleguar të njëjtit nëpër ato misione, në pajtim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Përrjashtim nga rregulli për të qenë diplomatë karriere mund të bëjnë Ambasadori/Shefi i Misionit, të cilët mund të jenë edhe emërimet politike, në proporcion 50% me 50%, bazuar në **Ligjin nr. 03/L-207**², si dhe stafi lokal në vendin ku operon misioni, nuk është e nevojshme të jenë pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

² Ligji nr. 03/L-207 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-122 parasheh që:

- 1 Misionet diplomatike të Republikës së Kosovës hapen, riorganizohen dhe mbyllen me vendim të Presidentit të Republikës, pas konsultimit me Kryeministrin;
- 2 Misionet diplomatike veprojnë nën mbikëqyrjen dhe në pajtim me udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- 3 Mënyra e funksionimit, struktura dhe numri i personelit të misioneve diplomatike përcaktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme”.

II. Metodologjia

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me vlerësimin e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili është i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-207; Ligjit nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit nr. 03/L-125 për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore. Ky hulumtim po ashtu analizon Projektligjin nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës për të analizuar nëse i njëjti i adreson çështjet të cilat janë identifikuar si problematike në zbatimin e legjislacionit aktualisht në fuqi.

Në kuadër të këtij hulumtimi, janë trajtuar këto çështje:

- 1.** A është zbatuar legjislacioni i cili është aktualisht në fuqi?
- 2.** Identifikimi i mangësive eventuale në legjislacionin aktualisht në fuqi?
- 3.** A janë të definuara qartë kompetencat e MPJ-së dhe institucioneve që bëjnë udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit, në ligjet të cilat janë aktualisht në fuqi?
- 4.** A është i nevojshëm miratimi i një Ligji të ri për MPJ-në dhe Shërbimin e Jashtëm?
- 5.** A i adreson këto çështje Projektligji për Shërbimin e Jashtëm, i cili ishte dorëzuar në Kuvend në legjislaturën e kaluar?

Përgjigjet në këto çështje janë provuar të merren përmes: (I) analizës së Ligjit aktual, akteve nënligjore, analizimit të projektligjit nr. 06/L-154 të dorëzuar në Kuvend në legjislaturën e kaluar me datë 11 mars 2019, si dhe Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961) dhe Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1964); (II) analizës së raporteve të publikuara nga mediat, institucionet dhe organizatat e tjera që merren me monitorimin e politikës së jashtme; (III) përmes intervistave me persona të cilët kanë shërbyer dhe/ose shërbejnë akoma në shërbimin e jashtëm, duke e ruajtur identitetin e tyre.

Në kuadër të këtij hulumtimi, janë trajtuar këto çështje:

- 1 A është zbatuar legjislacioni i cili është aktualisht në fuqi?
- 2 Identifikimi i mangësive eventuale në legjislacionin aktualisht në fuqi?
- 3 A janë të definuara qartë kompetencat e MPJ-së dhe institucioneve që bëjnë udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit, në ligjet të cilat janë aktualisht në fuqi?
- 4 A është i nevojshëm miratimi i një Ligji të ri për MPJ-në dhe Shërbimin e Jashtëm?
- 5 A i adreson këto çështje Projektligji për Shërbimin e Jashtëm, i cili ishte dorëzuar në Kuvend në legjislaturën e kaluar?

Përgjigjet në këto çështje janë provuar të merren përmes:

- I analizës së Ligjit aktual, akteve nënligjore, analizimit të projektligjit nr. 06/L-154 të dorëzuar në Kuvend në legjislaturën e kaluar me datë 11 mars 2019, si dhe Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961) dhe Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1964);
- II analizës së raporteve të publikuara nga mediat, institucionet dhe organizatat e tjera që merren me monitorimin e politikës së jashtme;
- III përmes intervistave me persona të cilët kanë shërbyer dhe/ose shërbejnë akoma në shërbimin e jashtëm, duke e ruajtur identitetin e tyre.

III. Legjislacioni qe rregullon funksionimin e Shërbimit të Jashtëm

Ligji nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datën 13 mars 2008, dhe i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar me **Ligjin nr. 03/L-207**, i miratuar me datë 8 korrik 2010, si dhe i shpallur me dekretin nr. DL-037-2010, të datës 28 korrik 2010.

Ky Ligj ka 12 dispozita të cilat rregullojnë aspektet esenciale të funksionimit të shërbimit të jashtëm, duke rregulluar kështu infrastrukturën bazike, por jo duke e rregulluar funksionimin e shërbimit në mënyrë të konsoliduar dhe të detajuar. Ky Ligj, pra, rregullon mënyrën e funksionimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, misioneve diplomatike dhe atyre konsullore, personelit të shërbimit të jashtëm, çështjet e emërimit të shefave të misioneve dhe personelit të tyre, si dhe çështje që ndërlidhen me menaxhimin financiar dhe atë të prokurimit.

Ligji nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës është miratuar me datë 16 dhjetor 2008, dhe është shpallur me dekretin nr. DL-071-2008 më datë 30 dhjetor 2008. Kurse, në po të njëjtat data, është miratuar nga Kuvendi i Republikës dhe dekretuar nga Presidenti i Republikës edhe **Ligji nr. 03/L-125 për Shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës**.

Ligji për Shërbimin e Jashtëm ofron një kornizë më të gjerë, me anë të së cilës plotësohet Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, mirëpo duke mos e shfuqizuar atë. Ky Ligj merret ekskluzivisht me çështje të ndërlidhura me misionet diplomatike dhe çështjet që ndërlidhen me shërbimin diplomatik në përgjithësi, mirëpo duke mos e mbuluar pjesën e gradave konsullore, të cilat i lihen në ekskluzivitet Ligjit nr. 03/L-125 për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore.

Ligji nr. 03/L-125 për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore është shpallur me dekretin nr. DL-073-2008 të datës 30 dhjetor 2008. Ky Ligj ka gjithsej 18 dispozita, dhe merret ekskluzivisht me çështjet rregullative që kanë të bëjnë me misionet konsullore dhe çështjet konsullore në përgjithësi, duke filluar që nga emërimi i konsujve e deri tek taksat konsullore.

Përveç ligjeve të cituara më sipër, funksionimi i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës bëhet edhe me anë të rregulloreve, konkretisht *Rregullores për Shërbimin e Jashtëm*, e nxjerrë në vitin 2009 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe *Rregullores për Shërbimin Konsullor*, e nxjerrë nga Ministria e Punëve të Jashtme, po ashtu në vitin 2009.

IV. Institucionet kompetente për funksionimin e Shërbimit të Jashtëm

Institucionet kompetente për realizimin e politikës së jashtme të vendit janë: Ministria e Punëve të Jashtme si dhe institucionet në vartësi të saj, konkretisht Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme, pra, bën zbatimin e politikës së jashtme të shtetit, si dhe bën përfaqësimin e shtetit jashtë, duke i zbatuar prioritetet e Qeverisë, mirëpo duke u koordinuar me Presidentin e Republikës, i cili është bartës i politikës së jashtme sipas Kushtetutës, Neni 84 (10), si dhe duke i raportuar Kuvendit.

Ambasadat dhe Konsullatat bëjnë përfaqësimin e vendit, dhe mbrojnë interesat e shtetit, në ato vende ku janë të akredituara (ambasadat), si dhe në rrethet/distriktet (konsullatat).

“

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME SI DHE INSTITUCIONET NË VARTËSI TË SAJ, KONKRETIŠHT AMBASADAT DHE KONSULLATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, PRA, BËN ZBATIMIN E POLITIKËS SË JASHTME TË SHTETIT, SI DHE BËN PËRFAQËSIMIN E SHTETIT JASHTË, DUKE I ZBATUAR PRIORITETET E QEVERISË, MIRËPO DUKE U KOORDINUAR ME PRESIDENTIN E REPUBLIKËS, I CILI ËSHTË BARTËS I POLITIKËS SË JASHTME SIPAS KUSHTETUTËS, NENI 84 (10), SI DHE DUKE I RAPORTUAR KUVENDIT.

V. Të gjeturat nga hulumtimi

Mangësitë në legjislacionin aktual

Legjislacioni aktual i cili është në fuqi, dhe i cili rregullon fushën e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës lë shumë fusha të pambuluara në mënyrë konkrete, duke e lënë kështu në diskrecion të Ministrit/es të/së Punëve të Jashtme për të vendosur ecurinë e punëve në Ministri dhe nëpër misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

A Emërimet politike

Kjo ka lënë shumë hapësirë për keqpërdorim, sidomos tek çështjet e rotacionit dhe atë të emërimeve nëpër misionet diplomatike dhe konsullore. Mos-definimi i qartë, ka lejuar që politika të interferojë që nga procesi i rekrutimit të diplomatëve të rinj, e deri te gradimi i tyre, emërimi në misione diplomatike, si dhe tek rotacioni i tyre – duke ua zgjatur mandatin atyre të cilët kanë mbështetje politike edhe në rastet kur me ligj specifikohet ndryshe. Neni 6 i Ligjit nr. 03/L-207, pika 7.7 parasheh që “*Së paku pesëdhjetë përqind (50%) të emërimeve të Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve duhet të bëhet nga anëtarët në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës*”, ndërsa një gjë e tillë përgjithësisht nuk është respektuar, dhe në shumë raste është tejkaluar kuota prej 50% në emërimet politike. Një tjetër pikë e cila nuk është zbatuar, është pika 7.8 e po të njëjtit Nen të të njëjtit Ligj, ku parashihet që: “*Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm*”. Ekzistojnë shumë raste, kur të emëruarve politik në pozitën e Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve iu është ripërtërirë mandati, apo janë transferuar me shërbim në një shtet tjetër. Andaj, kjo pikë duhet të precizohet dhe të mos tolerohet shkelje të tilla.

B Mungesa e koordinimit ndërinstytucional dhe brenda-institucional

Ajo që e bën më të vështirë zbatimin e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm është edhe fakti i mos-koordinimit të brendshëm mes institucioneve kyçe që merren me zbatimin e politikës së jashtme – pra mes Presidencës, Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke pamundësuar një politikë të jashtme unike. Përpos mos-koordinimit të skenës politike, një tjetër problematikë në zbatimin e këtij Ligji është mungesa e koordinimit, dhe shpesh herë edhe rivaliteti, mes stafit politik dhe atij civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për këtë çështje, jo rrallë herë ndasitë brenda janë reflektuar edhe jashtë institucionit. Një rast i tillë, kujtojmë, është rasti kur Drejtoria e Përgjithshme e MPJ-së pati dërguar letër qarkore në Misionet Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, duke i udhëzuar ato që të mos sistemonin nëpër misionet e tyre stafin e emëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme, aso kohe Behgjet Pacolli.

Rivalitete të tilla përpos që pengojnë funksionimin e shërbimit të jashtëm, e rrezikojnë edhe daljen e shtetit si jo-serioz karshi shtetit pritës. Andaj, legjislacioni aktual nuk i specifikon në mënyrë të saktë rolet e të gjitha palëve, dhe për këtë arsye është shumë e nevojshme që problematikat e tilla të adresohen në ligjin e ri për Shërbimin e Jashtëm.

C Roli i Komisionit për Punë të Jashtme

Ajo çka mund të vërehet nga Ligji aktual, është se nuk precizohet roli i Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme, rol që duhet të ketë jo vetëm në monitorimin e politikës së jashtme, por edhe në fuqizimin e diplomacisë parlamentare. Madje, në Ligjin nr. 03/L-207, Neni 6, pika 7.5, thuhet se “*Raporti i Komisionit është konsultativ dhe nuk e detyron Presidentin e Republikës së Kosovës*” kur vie

puna tek emërimi i Ambasadorëve politik. Kjo gjë e minon rolin e Kuvendit, tek i cili duhet raportuar për çështjet që ndërlidhen me politikën e jashtme. Ajo që është vërejtur në të kaluarën është që, zakonisht, Ministrat e Punëve të Jashtme, i shmangen raportimit në Komision në baza të rregullta, dhe një gjë e tillë nuk jep mesazh të mirë për koordinimin e politikës së jashtme. Shërbimi i Jashtëm nuk është i plotë pa diplomacinë parlamentare, andaj rekomandohet që në ligjin e ri për Shërbimin e Jashtëm të specifikohet edhe roli që deputetët do të kenë në bërjen e përfaqësimit të vendit jashtë, përmes diplomacisë parlamentare.

D Roli i Akademisë Diplomatike

Një pjesë e nëpunësve në Shërbimin e Jashtëm kanë mungesë të theksuar të njohurive të procedurave, legjislacionit, rregullave e zakoneve të cilat janë të nevojshme për përfaqësimin jashtë të Republikës së Kosovës. Këtu, roli i Akademisë Diplomatike (AD) duhet të jetë jetik në krijimin e kuadrove të reja. Akademia Diplomatike, në mënyrën si funksionon aktualisht, është një institucion i cili bën trajnimin e diplomatëve të rekrutuar, andaj është e domosdoshme që këto trajnime të intensifikohen, dhe të zgjerohen e të bëhen obligative për anëtarët e Shërbimit të Jashtëm. Vitin e fundit, vërehet një dinamikë më e madhe në punën e AD-së, e cila ka filluar të organizojë trajnime të rregullta jo vetëm për diplomatët e sapo-rekrutuar, por për të gjithë stafin e Shërbimit, si dhe për nëpunësit e Ministrive të tjera – gjë kjo e cila më herët ka qenë e mangët, ani pse parashihet në mandatin e Akademisë, konkretisht në pikat 2 dhe 3 të Nenit 4 [Veprimtaria e Akademisë] të *Rregullores Nr. 01-2012 për Funksionimin e Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës*:

2. Organizon dhe udhëheqë trajnime të stafit diplomatik dhe konsullor
3. Organizon dhe udhëheqë trajnime të stafit të ministrive gjegjëse të cilët përgatiten për të shërbyer në Misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit”.

Në anën tjetër, përpos trajnimeve, Akademia Diplomatike do të duhej të ishte institucion elitari i arsimimit dhe edukimit të brezave të rinj të diplomatëve, për çka duhet që fushëveprimi i Akademisë të zgjerohet përtej atij që është aktualisht, duke e kthyer AD-në në institucion autonom brenda MPJ-së, i cili përveç që ofron trajnime, bën rekrutim si dhe shkollon brezat e rinj të diplomatëve kosovar.

Pra, përderisa AD-ja aktualisht ofron trajnime dhe shërben si një lloj “kursi” për nëpunësit e pranuar tashmë në Shërbimin e Jashtëm, rekomandim i joni do të ishte që ky institucion të shndërrohet në një shkollë profesionale e cila ofron shkollime postdiplomike për të gjithë ata që janë të interesuar në fushën e diplomacisë, dhe në të njëjtën kohë i rekruton në Shërbim kuadrot më të mira që dalin në përfundim të këtij shkollimi. Pra, të merret parasysh praktika e Akademisë Diplomatike të Vjenës, dhe të synohet shndërrimi i AD-së në institucion elitari.

Në ligjin e ri, po ashtu, duhet të adresohen dhe të eliminohen paqartësitë rreth emërtimeve dhe termave të përdorura, si p.sh.: *“autoritetet institucionale”* dhe *“nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm”*; *“anëtarët e personelit të misionit”* dhe *“anëtarët e Shërbimit të Jashtëm”*; *“personeli administrativ dhe teknik”*, *“personeli diplomatik”* dhe *“personeli shërbyes”*; *“Shërbimi i Jashtëm”* dhe *“Shërbimi Diplomatik”* etj. Pra, Shërbimi i Jashtëm dhe Shërbimi Diplomatik janë e njëjta gjë, andaj të shmangen në hartimin e ligjit të ri, pasi që paqartësi të tilla në terma dhe emërtime krijojnë konfuzion jo-vetëm për ata që e lexojnë ligjin, por edhe për vetë nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm.

E Pagat bazë dhe shtesat

Në mënyrën se si funksionon aktualisht Shërbimi, të gjithë shërbyesit në misionet të cilët kanë grada diplomatike dhe konsullore, janë subjekt i trajtimit të barabartë financiar, përkitazi me gradën të cilën e mbajnë. Kjo gjë e pamundëson funksionimin adekuat të misioneve, për shkak se standardi i jetesës dallon nga njëri vend në tjetrin, dhe është trajtim i padrejtë kur të njëjtën pagë e marrin si diplomatët të cilët shërbejnë në Tiranë për shembull, me ata në Tokio, bie fjala. Përderisa Tirana ka një standard të përafërt jetese me Prishtinën, pagat të cilët diplomatët tanë i marrin gjatë periudhës kur ata shërbejnë në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, u japin atyre mundësi për një jetesë të dinjitetshme dhe mbi-mesatare. Në anën tjetër, Tokio në të gjitha rang-listat e qyteteve më të shtrenjta për të jetuar, radhitet si një nga qytetet më të shtrenjta në botë, kurse diplomatët e Republikës së Kosovës në Tokio marrin paga të njëjta sikurse diplomatët e Republikës së Kosovës me shërbim në Tiranë.

Një situatë e tillë, pos që i vë diplomatët tanë në pozitë të vështirë, i vë në pozitë të vështira edhe raportet mes shteteve. Meqë më sipër u mor shembulli i Ambasadës së Republikës së Kosovës në Tokio, atëherë duhet kujtuar se Ambasada jonë në Tokio kishte mbetur pa Ambasador për një periudhë afro dy vjeçare, më saktësisht prej datës 13 dhjetor 2014 kur edhe i kishte mbaruar mandati Ambasadorit Ahmet Shala, deri me 7 shtator 2016 kur në këtë pozitë emërohet Leon Malazogu. Pra, për një periudhë afro dy vjeçare, Republika e Kosovës ka ulur nivelin e saj të përfaqësimit në Japoni në nivel të Ngarkuari me Punë, dhe kjo, ndër tjera, edhe për faktin e hezitimit për të shërbyer në Japoni për shkak të disproporcionit mes nivelit të të ardhurave dhe kostos së jetesës.

Kjo çështje duhet të trajtohet në ligjin e ri për shërbimin e jashtëm, pasi që situata të tilla si kjo e përmendur më sipër, ndikojnë jo vetëm në imazhin e shtetit, por edhe në marrëdhëniet me shtetin pritës.

Një gjë tjetër e cila duhet pasur parasysh kur të trajtohen pagat dhe shtesat për diplomatët e Republikës së Kosovës, është fakti se jo doemos standardi i jetesës në një shtet e përcakton edhe koston e jetesës në atë shtet. Për ta ilustruar me shembuj, Republika e Kosovës aktualisht ka Ambasada rezidente në Dakar të Senegalit dhe në Dhaka të Bangladeshit.

Vërtetë standardi i jetesës në të dyja këto vende është i ulët, dhe në shikim të parë kjo nënkupton se diplomatët tanë me shërbim në këto shtete mund të bëjnë një jetë të dinjitetshme, mirëpo nëse merret parasysh se në të tilla vende liria e lëvizjes për diplomatë të huaj është e kufizuar (qoftë për arsye sigurie, qoftë për arsye të tjera), atëherë duhet pasur parasysh se jeta e këtyre diplomatëve është e kufizuar në një rreth të caktuar, në zona të caktuara brenda qyteteve në të cilat shërbejnë – vende këto që zakonisht frekuentohen nga punonjësit e koreve diplomatike dhe nga zyrtarët e qeverive respektive. Rrjedhimisht, këto zona kanë edhe kosto më të lartë, dhe shërbimet në to – për shkak të ekskluzivitetit – janë shumëfish më të larta se sa që do të ishin rëndom në cilindo qytet Evropian.

Pra, përderisa një diplomat i Kosovës me shërbim në Berlin, për shembull, mund të udhëtoj lirshëm, të furnizohet me ushqim në cilëndo pjesë të qytetit, të shkojë në cilindo restaurant dhe të merret me aktivitete rekreative kudo, një diplomat i cili shërben në njërin nga misionet e përmendura më sipër duhet ta bëjë këtë në zonë të veçantë, pa pasur mundësi zgjedhjeje për çmime më të lira.

Një problematikë tjetër me të cilën përballen diplomatët tanë të cilët janë me shërbim në vise të largëta, është edhe fakti që Ministria mbulon koston e udhëtimit me rastin e fillimit të misionit dhe me rastin e përfundimit të tij. Pra, do të ishte mirë që Ministria të mbulojë po ashtu koston e udhëtimit një herë në vit për pushim, dhe propozimi jonë do të ishte që për Shefin e Misionit të mbulohet kostoja e plotë e biletës, përderisa për pjesën tjetër të familjes, Ministria të mbulojë 80% të kostos së biletës – për të inkurajuar, pra, gjetjen e opsioneve më të lira për vajtje-ardhje.

F Shkollimi i fëmijëve

Sa i përket shkollimit të fëmijëve të diplomatëve kosovar, duhet pasur parasysh se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës aktualisht mbulon kosto deri në 250€/muaj për shkollimin fillor dhe të mesëm të fëmijëve të diplomatëve tanë, sipas Nenit 20, pika 4 e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm. Për ato vende ku diplomatët mund t'i shkollojnë fëmijët në shkolla publike, një shumë e tillë mund të jetë e mjaftueshme për t'i mbuluar këto shpenzime. Ndërsa, për ato vende ku është e pamundur që fëmijët të shkollohen në shkolla publike, si në rastin e Bangladeshit, Senegalit, Emirateve të Bashkuara Arabe, Katarit, Arabisë Saudite, Tajlandës etj., atëherë një shumë e tillë është shumë e vogël, dhe i detyron diplomatët që të bëjnë zgjedhje mes marrjes së familjeve në mision, apo shkuarjes në mision të vetëm. Në rastin e dytë, duhet pasur parasysh që të njëjtit nuk do të mund t'i performojnë plotësisht detyrat e tyre të parashikuara, pasi që do të duhet të marrin pushim më shpesh për të kaluar kohë me familjet e tyre.

Ligji Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës në Kreun V, Neni 34, pika 3 thotë:

"Ministria e Punëve të Jashtme garanton arsimin fillor dhe të mesëm të fëmijëve të anëtarëve të personelit të misionit diplomatik dhe ku është e nevojshme, siguron financimin e këtij arsimimi. Mënyra, kriteret dhe kushtet e financimit përcaktohen me Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm".

Ndërsa pika 2 e Nenit 20 të Rregullores për Shërbimin e Jashtëm parasheh që:

"Kur në shtetin pranues sistemi shkollor zhvillohet në gjuhë të ndryshme nga gjuhët e huaja që mësohen në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës dhe për këtë arsye shkollimi bëhet në shkolla ndërkombëtare private, të licencuara, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të anëtarëve të personelit të misionit, mbulohen pjesërisht, kur kjo është e përballueshme nga buxheti i lejuar për Ministrinë".

Pra, është e qartë që Ministria e Punëve të Jashtme është e obliguar të sigurojë financimin e shkollimit për fëmijët e personelit të Shërbimit të Jashtëm, sidomos aty ku nuk mësohet në njërin nga gjuhët që mësohen në sistemin arsimor të Kosovës, mirëpo një gjë e tillë nuk mund të arrihet me shumën e cila aplikohet aktualisht, pra 250€/muaj, ose 3,000€/vit.

Ajo që mund të konkludohet nga analizimi i legjislacionit aktualisht në fuqi, është se si i tillë, shërben si një lloj kodifikimi i Shërbimit të Jashtëm, i cili rregullon funksionimin e Ministrisë dhe Shërbimit në terma të përgjithshëm, mirëpo duke mos hyrë shumë në detaje. Mangësi i legjislacionit aktual është fakti që nuk i mbulon dhe nuk i rregullon shumë fusha të rëndësishme, si çështjet e rotacionit, shtesave, trajtimet e familjeve të diplomatëve etj., të cilat aktualisht mbulohen me akte nënligjore dhe me rregullore të punës. Duke qenë se një pjesë e madhe e punës së Shërbimit të Jashtëm rregullohet me anë të akteve nënligjore, kjo i lë mundësi titullarëve që të marrin vendime të cilat shpesh herë nuk janë në përputhje me praktikën dhe zakonet e diplomacisë, si për shembull hapja e dy misioneve të ndara brenda një qyteti, si në rastin e Ambasadës dhe Konsullatës së Përgjithshme në Tiranë. Praktika diplomatike nuk e parasheh që në një qytet të vetëm të ketë dy misione të ndara të të njëjtit shtet. Pra, Ambasada vendoset në kryeqytet, dhe e njëjta ofron shërbimet e nevojshme konsullore për të gjithë qytetarët në nevojë, ndërsa Konsullatat hapen në qytetet e tjera, varësisht nga madhësia e tyre, apo rëndësia që një qytet mund të ketë për shtetin dërgues (numri i nënshtetasve që jetojnë në atë qytet, lidhjet historike, lidhjet ekonomike etj.).

Pra, ligji i ri duhet të jetë më i kompletuar dhe më i detajuar, si dhe duhet të bëjë rregullimin e aspekteve të cekura më sipër për të mos lënë në diskrecion të titullarëve marrjen e vendimeve të cilat potencialisht mund të jenë në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare, dhe rrjedhimisht mund të dëmtojnë reputacionin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, si dhe funksionimin e Shërbimit të Jashtëm.

VI. Projektligji nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Projektligji nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili ishte dorëzuar në legjislaturën e kaluar të Kuvendit të Republikës së Kosovës me datë 11 mars 2019, është më gjithëpërfshirës se sa legjislacioni i cili është aktualisht në fuqi dhe i cili e rregullon fushën e politikës së jashtme. Në përgjithësi, ky projektligji ka gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, shërben si një lloj kodifikimi për të gjithë legjislacionin relevant i cili mbulon fushën e politikës së jashtme, si dhe përmirëson disa nga mangësitë të cilat janë vërejtur gjatë punës operacionale të Shërbimit të Jashtëm, i cili tashmë ka hyrë në dekadën e dytë të funksionimit.

Megjithatë, edhe ky projektligj nuk i adreson qartë disa nga problemet me të cilat ballafaqohet Shërbimi i Jashtëm. Neni 4, pika 4 në këtë projektligj parasheh që:

“Ministri lidhur me politikën e jashtme i raporton Kryeministrit, Kuvendit, si dhe e informon Presidentin lidhur me zbatimin e politikës së jashtme”,

ndërsa pika 2.1 e Nenit 7 parasheh që:

“[Ministria] bashkërendon qëndrimet zyrtare me Qeverinë dhe Presidentin”.

Pra, ka një diskrepancë mes këtyre pikave për sa i përket rolit të Presidentit në politikën e jashtme. Duhet të tentohet të shmangen keqkuptimet të cilat rëndom kanë ndodhur gjatë gjithë shtetësisë së Kosovës lidhur me rolin e Presidentit në politikën e jashtme. Duke pasur parasysh që Neni 84 (10) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që: “[Presidenti i Republikës së Kosovës]: ... udhëheq politikën e jashtme të vendit; ...”, do të ishte mirë që në Ligjin e ri për politikën e jashtme të definohej qartë se cili është roli i Presidentit në këtë fushë, duke e respektuar edhe Aktgjykimin nr. K043/19 të Gjykatës Kushtetuese në rastin e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, si dhe të definojë qartë çfarë lloji të bashkërendimit duhet të ketë mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Zyrës së Kryeministrit dhe Zyrës së Presidentit, për të evituar problemet me të cilat diplomacia kosovare është ballafaquar gjatë periudhës 12 vjeçare të ekzistencës së saj.

Po ashtu, te Neni 8 i projektligjit, është e paqartë struktura organizative e Ministrisë, pasi që renditja në këtë projektligj është si vijon:

- 1 Ministri
- 2 Sekretari i Përgjithshëm
- 3 Drejtori Politik
- 4 Drejtoritë e Përgjithshme
- 5 Akademia Diplomatike
- 6 Protokolli Diplomatik
- 7 Departamentet
- 8 Divizionet

Ndërsa, sugjerimi jonë do të ishte që struktura organizative e Ministrisë të jetë si vijon:

- 1 Ministri
- 2 Sekretari i Përgjithshëm
- 3 Drejtori i Përgjithshëm
- 4 Drejtori Politik
- 5 Akademia Diplomatike
- 6 Protokollu Diplomatik
- 7 Drejtoritë/Departamentet
- 8 Divizionet

Koment: Në projektligj parashihet që të ketë një 'Drejtor Politik' si dhe (disa) 'Drejtoritë të Përgjithshme'. Në strukturën organizative të Ministrisë, aktualisht ekziston pozita e *Drejtorit të Përgjithshëm* e cila nuk parashihet në projektligjin e ri. Andaj, do të ishte mirë që të qartësohet dhe të ri-formulohet kjo pikë, pasi që është e palogjikshme që të ketë disa 'Drejtoritë të Përgjithshme', në vend të 'Drejtorive'. Prandaj, do të ishte mirë që të kthehet pozita e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili do të ishte në hierarki pas Sekretarit të Përgjithshëm, para Drejtorit Politik.

Te Neni 11 (Drejtori Politik), të riformulohet pika 3, ku thuhet se: *"Mandati i Drejtorit Politik është katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme"*.

Koment: Kjo pikë sugjerohet të riformulohet si vijon: *"Mandati i Drejtorit Politik është katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat të dytë"*. Kjo pasi që formulimi aktual në projektligj nënkupton që pas dy mandateve njëpasnjëshme, dhe pas një pauze disa vjeçare, Drejtori Politik ka të drejtë për tu rizgjedhur në të njëjtën pozitë.

A Shtetësia e Shefit të Misionit

Te Neni 23 (Kushtet për emërimin e Shefit të Misionit Diplomatik), pika 1.2 thotë që "[Shefi i Misionit Diplomatik] të mos ketë shtetësinë e shtetit pritës", ndërsa Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961) nuk e përjashton një gjë të tillë. Në Nenin 8, pika 2 thotë: *"Anëtarët e personelit diplomatik nuk mund të emërohen nga radhët e personave të cilët kanë shtetësinë e shtetit pritës, përveç me pëlqimin e atij shteti, pëlqim i cili mund të tërhiqet në çdo kohë"*.

B Trajtimi i familjeve të diplomatëve

Një gjë e cila nuk trajtohet as nga ligjet aktualisht në fuqi e as në këtë Projektligj, është trajtimi i familjeve të personelit të misionit diplomatik dhe atij konsullor. Në këtë kuadër, komentet e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Gjenevë në Memorandumin Shpjegues për Projektligjin në fjalë për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, janë më të përafërta me praktikat ndërkombëtare, andaj është edhe rekomandim i joni që të futen në projektligj si Nen i veçantë.

Në komentet e Konsullatës së Përgjithshme në Gjenevë në Memorandumin Shpjegues për Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm kërkohet që familjarët e diplomatëve të gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vendet ku shërbejnë; bashkëshortëve t'ju llogaritet koha e qëndrimit jashtë vendit për efekt të vjetërsisë në punë; bashkëshortët të marrin 50% të pagës bazë të diplomatëve të gradës Atashe/Sekretar i Tretë (në rast se në shtetin ku janë nuk ju lejohet të punojnë); t'ju paguhen kontributet pensionale nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme; në rast se bashkëshorti/ja kanë punuar në institucion publik para shkuarjes në mision, të kenë të drejtë që pas kthimit të rëmërohen në të njëjtën pozitë, apo në një pozitë të barasvlefshme me të; t'i mbulohet kostoja e shkollimit të fëmijëve në rastet kur është e pamundur që fëmijët të shkollohen në shkolla publike, apo kur shkollimi në shkollat publike nuk është në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht ose italisht.

Në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, tek Neni 7, pika 6 thuhet: *“Anëtarët e familjes së ngushtë inkurajohen që të shoqërojnë përfaqësuesit diplomatik në funksionet e tyre jashtë shtetit, si dhe të marrin pjesë në jetën e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore”*. Andaj, meqë shoqërimi i familjarëve, inkurajohet edhe me këtë Rregullore, do të ishte mirë që MPJ-ja t’i ofronte kushtet për jetesë dinjitoze për familjarët e diplomatëve, në mënyrë që ata t’i përmbushin me lehtësi detyrat dhe obligimet e përfaqësimit të vendit, të parapara me këto akte.

Projektligji si i tillë, po ashtu nuk e adreson edhe një problematikë tjetër, e cila është cekur më sipër në analizën e legjislacionit aktual në fuqi – shtesat për shërbyesit diplomatik varësisht nga vendi në të cilin janë të akredituar. Pra, projektligji i ri duhet që po ashtu të trajtojë edhe çështjen e pagesës së shtesave, varësisht nga vendi se ku nëpunësit e misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës shërbejnë.

C Tërheqja e parakohshme e Shefit të Misionit

As legjislacioni në fuqi dhe as ky projektligj nuk e trajtojnë çështjen e tërheqjes së parakohshme të Shefit të Misionit. Duhet pasur parasysh që Shefi i Misionit duhet të tërhiqet vetëm në raste të natyrës serioze, dhe këto raste duhet të parashihen edhe me ligj. Ndërrimi i shpeshtë i Shefave të Misioneve në një vend, pa arritur që ta përfundojnë mandatin e tyre të plotë katër vjeçar, paraqet imazh të keq për shtetin. Andaj, është e nevojshme që të përkufizohen saktësisht rastet kur duhet të bëhet një tërheqje e parakohshme e Shefit të Misionit, por edhe e diplomatëve me rang më të ulët.

D Dhënia e gradave

Në projektligj, po ashtu duhet të precizohet roli i Ministrit/es për dhënien e gradave nga ana e Komisionit të Gradave dhe Disiplinës. Ministrit/es duhet t’i lihet e drejta, sipas kritereve

të përcaktuara në ligj, për të shtuar një gradë më tepër se sa ajo që ka rekomanduar Komisioni, mirëpo nuk duhet lënë në diskrecion të tij/saj uljen e gradës të cilën e jep Komisioni, për t’ju shmangur ndëshkimit të padrejtë, si dhe padrejtësive të tjera të mundshme me motive personale.

Në projektligjin e ri nuk përcaktohet se kush është autoriteti i cili bën pezullimin dhe merr vendimin për kthim të atasheve të deleguar nga Ministritë dhe autoritetet e tjera (Atasheu i Mbrojtjes, Policor, Kulturor etj.) – pra duhet të definohet nëse në raste të tilla vendimin e merr Ministria zyrtar i së cilës Atasheu është, apo MPJ-ja. Megjithëse, nënkuptohet që në të tilla raste do të duhej të kishte koordinim mes të dyja institucioneve, do të ishte mirë që kjo të specifikohet dhe të parashihet për rastet kur mund të ketë mosmarrëveshje/mospajtime në lidhje me vendimet e njërës apo tjetrës palë.

E Konsujt e Nderit

Në këtë projektligj, për dallim nga legjislacioni aktualisht në fuqi, parashihet edhe një Nen i veçantë për Konsujt e Nderit. Republika e Kosovës ndër vite ka emëruar shumë Konsujt Nderi, numri i të cilëve nuk dihet, pasi që nuk është mbajtur evidencë për këto emërimë. Ajo që ka ndodhur me emërimet e Konsujve të Nderit, është që njerëz të afërt me politikën, por që vijnë nga radhët e botës së biznesit, kanë përfitur nga emërimet e tilla, duke përfitur kështu nga lirimet nga taksat e ndryshme, si dhe duke përdorur beneficionet që makinat me targa diplomatike sjellin me këtë post.

Përpos benefiteve të cilat këto pozita i sjellin, vijnë edhe përgjegjësitë, pasi që Konsujt e Nderit duhet t’i mbrojnë interesat e Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj në ato vende ku jetojnë. Mirëpo, Konsullatat e Nderit të Republikës së Kosovës në botë janë pothuajse jo-ekzistente dhe jo-funksionale, pavarësisht emërimeve të shumta që kanë ndodhur.

Pra, në ligjin e ri, do të ishte mirë që të trajtohet çështja e Konsujve të Nderit me një kapitull të veçantë, si dhe Ministria

e Punëve të Jashtme të obligohet për krijimin e një baze të të dhënave me listën e Konsujve dhe Konsullatave të Nderit të cilët i ka nëpër botë, të kontrollojë veprimtarinë e tyre, si dhe t'i bëjë publike në ueb faqen zyrtare të MPJ-së lokacionet dhe kontaktet e këtyre Konsullatave të Nderit, në mënyrë që në rast nevojë, qytetarët e Republikës së Kosovës të dijnë ku të drejtohen. Aktualisht, MPJ nuk posedon një bazë të të dhënave për Konsujt e Nderit të cilët janë emëruar ndër vite.

F Përfaqësimi gjinor

Ky projektligj, po ashtu, nuk parasheh një kuotë të përfaqësimit të grave në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Andaj, do të duhej të vendosej një kuotë edhe për përfaqësimin gjinor në kuadër të secilit mision veç e veç, por edhe në kuadër të emëruarve si Shefa Misionesh, për të ruajtur balancën e përfaqësimit gjinor, si dhe për të reflektuar balancën e cila parashihet edhe me **Ligjin për Barazi Gjinore**. Në Kuvend respektohet kuota prej 30% përfaqësim të grave, ani pse Ligji parasheh që të ketë përfaqësim të barabartë, mirëpo kjo kuotë nuk respektohet edhe në institucionet e tjera shtetërore, andaj Shërbimi i Jashtëm mund të kthehet në institucion lider nga radhët e ekzekutivit, aq më tepër marrë parasysh faktin që Shërbimi i Jashtëm pasqyron imazhin e shtetit në botë.

Lidhur me këtë çështje, **Ligji për Barazi Gjinore** parasheh që *“përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind për secilën gjini”, dhe i njëjti duhet pasur parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri për Shërbimin e Jashtëm.*

Neni 6 i këtij Ligji [Masat e veçanta] shprehimisht kërkon që:

1. Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përsheptimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.

2. Masat e veçanta mund të përfshijnë:

2.1. kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve”.

Pra, fillimisht të vendoset një kuotë e cila do të mund të modifikohet me kalimin e kohës, derisa të arrihet përfaqësimi minimal prej pesëdhjetë për qind, i paraparë me ligjin e sipërcituar.

Nga të dhënat e ueb-faqes zyrtare të MPJ-së, Kosova aktualisht ka gjithsej 46 misione; prej tyre 32 ambasada, 13 konsullata dhe 1 zyrë të veçantë ekonomike në Athinë. Vetëm 5 nga 32 ambasadat e Republikës së Kosovës (rreth 15%) udhëhiqen nga gra, kurse vetëm 3 nga 13 konsullata (rreth 23%) udhëhiqen nga gra.



NGA TË DHËNAT E UEB-FAQES ZYRTARE TË MPJ-SË, KOSOVA AKTUALISHT KA GJITHSEJ 46 MISIONE; PREJ TYRE 32 AMBASADA, 13 KONSULLATA DHE 1 ZYRË TË VEÇANTË EKONOMIKE NË ATHINË. VETËM 5 NGA 32 AMBASADAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (RRETH 15%) UDHËHIQEN NGA GRA, KURSE VETËM 3 NGA 13 KONSULLATA (RRETH 23%) UDHËHIQEN NGA GRA.

VII. Rekomandimet

1. Të përcaktohet saktë procedura e rotacionit dhe rastet kur një gjë e tillë i lihet në diskrecion Ministrit/-es së Punëve të Jashtme;
2. Të përkufizohet kuota e të emëruarve politik në krye të misioneve, dhe në rast se gjykohet e nevojshme (për shkak të mungesës së kuadrove në Shërbimin e Jashtëm), të rikthehet kuota e vjetër prej 50%, por që e njëjta të respektohet me përpikmëri;
3. Të emëruarit në pozitën e Shefave të Misioneve, të cilët nuk vijnë nga radhët e Shërbimit të Jashtëm, pra që janë të emëruar politik, të kenë të përcaktuar kohëzgjatjen e shërbimit të tyre. Të përcaktohet po ashtu nëse atyre iu lejohet zgjatja e mandatit, apo dërgimi në një shtet tjetër, marrë parasysh faktin që pesha politike, në të kaluarën ua ka mundësuar një gjë të tillë. Në legjislacionin aktualisht në fuqi parashihet që të emëruarit politik të shërbejnë vetëm një mandat, mirëpo këtu ka një zbrazëti, pasi që nuk precizohet fakti nëse kjo vlen vetëm për shtetin në të cilin janë emëruar, apo të njëjtit mund të emërohen për një mandat tjetër në një shtet tjetër;
4. Të adresohet çështja e tërheqjes së parakohshme e Shefave të Misionet dhe diplomatëve të tjerë, si dhe të përcaktohen rastet kur një gjë e tillë mund të bëhet, dhe arsyet për të cilat bëhet tërheqja e parakohshme. Ndërrimi i shpeshtë i Shefave të Misionit, sa herë që ndërrohet Qeveria, dëmton imazhin e Republikës së Kosovës në shtetin pritës, dhe tregon jo-qëndrueshmëri institucionale;
5. Të përcaktohet roli i institucioneve të larta të shtetit (Presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë) në politikën e jashtme, pasi që mospajtimet mes tyre lidhur me Shërbimin e Jashtëm, reflektohen edhe në shtetet pritëse, dhe jo-rrallëherë kjo i vë në pozitë të vështirë misionet tona diplomatike dhe konsullore;
6. Të përcaktohet roli i stafit politik dhe atij civil brenda strukturës së Ministrisë, si dhe përgjegjësitë e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, për të shmangur përplasjet të cilat kanë ndodhur në të kaluarën;
7. Të përcaktohet roli i Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme në monitorimin e zbatimit të politikës së jashtme. Të promovohet diplomacia parlamentare, e cila do të ishte një vlerë e shtuar në përfaqësimin e vendit jashtë, si dhe në forcim të pozitës së Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare;

8. Ligji i ri të obligojë vendosjen e një kuote për përfaqësim gjinor në Shërbimin e Jashtëm, dhe Ministria të obligohet për të respektuar kuotën gjinore si në kuadër të stafit të Misioneve veç e veç, ashtu edhe në nivel të Shefave të Misioneve;
9. Të trajtohet çështja e pagës bazë dhe shtesave, varësisht nga vendi ku shërbejnë;
10. Të përcaktohet qartë mandati i Konsujve të Nderit, si dhe kriteret për emërim të Konsujve të Nderit. Ministria të krijojë një bazë të të dhënave me listën e Konsujve të Nderit, si dhe me kontaktet dhe lokacionet e Konsullatave të Nderit të Republikës së Kosovës nëpër botë, në mënyrë që qytetarët në nevojë të dijnë ku të drejtohen në rast nevoje;
11. Të fuqizohet roli i Akademisë Diplomatike, dhe të kthehet Akademia në një institucion elitar për rekrutimin, shkollimin dhe trajnimin e diplomatëve të rinj, duke marrë për bazë praktikën e shteteve të tjera, e veçanërisht shembullin e Akademisë Diplomatike të Vjenës;
12. Të adresohen paqartësitë në emërtimet e termave në Ligj, në mënyrë që të mos krijohet konfuzion as tek ata të cilët e lexojnë ligjin, e as tek nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës;
13. Të futet një Nen i veçantë, i cili rregullon trajtimin familjeve të diplomatëve, si dhe përgjegjësitë e Ministrisë karshi tyre, si në aspektin e shkollimit, punësimin, sigurimeve shëndetësore dhe atyre shoqërore, pagesës së kontributeve pensionale gjatë gjithë kohës sa qëndrojnë jashtë vendit, ruajtjes së vendit të punës (në rast se të njëjtit kanë punuar në institucione publike para shkuarjes jashtë vendit), pagesës së kontributeve pensionale, mbulimit të kostonë së udhëtimit etj.;
14. Të ristrukturohet organogrami i Ministrisë i paraparë në Projektligjin Nr. 06/L-154, ku parashihet heqja e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm. Është mirë që të ketë një Drejtor të Përgjithshëm, siç edhe është aktualisht, i cili në hierarkinë e MPJ-së është nën Sekretarin e Përgjithshëm, dhe i cili e mbikëqyrë punën e drejtorive të tjera, si dhe e asiston Ministrin/en në hartimin e politikës së jashtme. Në rast se vlerësohet e nevojshme krijimi i pozitës së 'Drejtorit Politik', i njëjti propozohet të jetë nën Drejtorin e Përgjithshëm.

Shtojca I: Propozimi e Konsullatës së Përgjithshme në Gjenevë lidhur me futjen e Nenit të veçantë i cili trajton çështjen e familjarëve të diplomatëve

1. Bashkëshorti/-ja i/e diplomatit, fëmijët deri në moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç nën kujdesin e diplomatit, si dhe personat në kujdestari ligjore të tij/saj, gëzojnë të drejtën e mbajtjes së pasaportës diplomatike.
2. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortin/-ën e diplomatit/-es dhe vetëm sigurimin shëndetësor për fëmijët deri në moshën 18 vjeç nën kujdesin e diplomatit, si dhe personat në kujdestari ligjore të tij/saj.
3. Bashkëshortit/-es të diplomatit/-es, i/e cili/a e shoqëron atë në detyrë në misionin diplomatik ose postin konsullor, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë. Për këtë periudhë, bashkëshorti/-ja i/e diplomatit/-es përfiton pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të pensionit sipas ligjit, të llogaritur mbi bazën e pagës bazë për gradën Atashe. Në rastet kur bashkëshorti/-ja nuk kanë qenë në marrëdhënie pune, si pagë referuese merret paga minimale e përcaktuar me ligj.
4. Bashkëshorti/-ja i/e diplomatit/-es, i/e cila e shoqëron atë në detyrë në misionin diplomatik ose postin konsullor, përfiton shpërblim mujor në vlerën 50% të pagës bazë të gradës Atashe/Sekretar i Tretë, e cila përcaktohet me vendim të Qeverisë.
5. Bashkëshorti/-ja që shoqëron diplomatit/-en e caktuar në misionin diplomatik ose postin konsullor ka të drejtë të punësohet në shtetin pritës në rastet kur kjo parashikohet me marrëveshje dypalëshe që Republika e Kosovës ka lidhur me shtetin pritës, ose kur lejohet nga shteti pritës. Kreu i misionit diplomatik ose postin konsullor njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme për këtë punësim. Në rast të punësimit, bashkëshortit/-es nuk i takon shpërblimi mujor sipas paragrafit 4 të këtij Neni.
6. Bashkëshorti/-ja, që në kohën e caktimit të diplomatit/-es jashtë shtetit ka punuar në institucion publik, ka të drejtë të riemërohet në të njëjtën pozitë pune ose në një pozicion të barasvlefshëm me të, pas kthimit në Kosovë. Institucioni shtetëror, ku bashkëshorti/-ja ka qenë i/e punësuar, ka detyrim ta emërojë atë brenda gjashtë muajve nga paraqitja e kërkesës për riemërim në këtë institucion.
7. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon financiarisht arsimimin fillor dhe të mesëm të fëmijëve të personelit të emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor. Ministria e Punëve të Jashtme siguron financimin e këtij arsimimi në rastet kur:
 - 7.1. Shkolla publike në vendin ku është akredituar përfaqësia është me pagesë;
 - 7.2. Gjuha e shkollimit në shkollat publike nuk është anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht.
8. Mënyra, kriteret dhe kushtet e financimit të parashikuara në këtë Nen përcaktohen me akt nënligjor.

Mbështetur nga:

